



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1390/24, Datë: 12/07/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 124-të, mbajtur me datë 25.06.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Prishtinës për periudhën **pesë (5) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2029):
 1. *Gjuhë Angleze (program i integruar i gjuhësisë) MA 60 ECTS, me kuotën maksimumi 20 studentë për vit akademik;*
 2. *Letërsi Angleze MA 60 ECTS, me kuotën maksimumi 20 studentë për vit akademik;*
 3. *Gjermanishtja si Gjuhë e Huaj MA 60 ECTS, me kuotën maksimumi 15 studentë për vit akademik;*
 4. *Gjuhë dhe Letërsi Gjermane MA 60 ECTS, me kuotën maksimumi 20 studentë për vit akademik;*
- II. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Fakulteti i Filologjisë – në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti i Filologjisë i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshimin e bartësve aprovohet me vendim nga KSHC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakulteti i Filologjisë i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1.	Gjuhë Angleze (program i integruar i gjuhësisë) MA 60 ECTS,	Lindita Tahiri
2.	Letërsi Angleze MA 60 ECTS,	Lirak Karjagdiu
3.	Gjermanishtja si Gjuhë e Huaj MA 60 ECTS,	Milote Sadiku
4.	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane MA 60 ECTS,	Blertë Ismajli

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Gjuhë Angleze (program i integruar i gjuhësisë) MA 60 ECTS***, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Beatriz López, Georg Schuppener, Katerina Klimoska dhe Juraj Bogat, është organizuar më 26.03.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht pesë (5) dhe Substancialisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Letërsi Angleze MA 60 ECTS***, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Beatriz López, Georg Schuppener, Katerina Klimoska dhe Juraj Bogat, është organizuar më 26.03.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht pesë (5) dhe Substancialisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit..
- Për programin e studimit; *Gjermanishtja si Gjuhë e Huaj MA 60 ECTS***, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Georg Schuppener Beatriz López, Katerina Klimoska dhe Juraj Bogat, organizuar më 26.03.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht gjashtë (6) dhe Substancialisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; *Gjuhë dhe Letërsi Gjermane MA 60 ECTS***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Georg Schuppener, Beatriz López, Katerina Klimoska dhe Juraj Bogat, është organizuar më 26.03.2024, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht gjashtë (6) dhe Substancialisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 124-të, të mbajtur më datë 25.06.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakultetit të Filologjisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë